



**Republika e Kosovës – Republika Kosova**  
**Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa**  
**Izborni Panel za Žalbe i Predstavke**

**Anr.738/2021**

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP), i përbërë nga gjyqtaret: Zyhdi Haziri kryesues, Burim Ademi dhe Ferki Xhaferi anëtar si dhe me pjesëmarrjen e zyrtares ligjore Edona Grajçevci, duke vendosur përkritazi me apelin e Rashit Qalaj, kandidat për deputet nga radhët e subjektit politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK), me seli në Prishtinë, dega në Ferizaj, paraqitur kundër vendimit të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ), Nr.860/2021 të datës 04.03.2021, për Zgjedhjet e Parakohshme për Kuvend të Kosovës të mbajtura me datë: 14.02.2021, në seancën e panelit të mbajtur më datë 05.03.2021, mori këtë:

**V E N D I M**

**I. Pranohet pjesërisht** si i bazuar apeli i Rashit Qalaj, Anr.738/2021, Anr.739/2021 , Anr.741/2021, Anr.743/2021 kandidat për deputet nga radhët e subjektit politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK), me seli në Prishtinë, dega në Ferizaj.

**II. Urdhërohet** Komisioni Qendror i Zgjedhjeve (KQZ) që të rinumëroj vetëm fletëvotimin për kandidatin për anëtar të Kuvendit Republikës së Kosovës, nga radhët e subjektit politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK), me seli në Prishtinë, dega në Ferizaj, në Vendvotimet: nr.1122b/02D në fshatin Kushtove në komunën e Mitrovicës, në vendvotimin me nr.2702B/04R, në komunën e Vushtrrisë, në vendvotimin me nr.2731B/02D në fshatin Akrashtice në komunën e Vushtrrisë, në vendvotimin me nr.1115b/01R në fshatin Bare në komunën e Mitrovicës.

**III. Refuzohet si e pabazuar** pjesa tjetër e apelit të Rashit Qalaj Anr.740/2021 Anr.742/2021, dhe Anr.744/2021 për vendvotimet 1326e/02D Shkolla fillore “katër dëshmorët” fsh. Krojmir Lipjan, 0306E/01R shkolla fillore “ Zenel Hajdini” fsh Terstenik Komuna e Drenasit, 1326e/01R shkolla Fillore “katër Dëshmorët”, fshati Krojmir Lipjan.

**IV. Rezultati** i cili del pas rinumërimit të fletëvotimeve në kutitë e Vendvotimeve si në pikën -II- të këtij dispozitivi, të përfshihen në rezultatin përfundimtar.

**A r s y e t i m**

PZAP-i, ka pranuar apelet me datën 05.03.2021, nga Rashit Qalaj, kandidat për deputet nga radhët e subjektit politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK), me të cilat pretendon se votat

gabimisht i janë përshkruar në formularët në vendvotimin me nr.1122b/02D në fshatin Kushtove në komunën e Mitrovicës, në vendvotimin me nr.2702B/04R, në komunën e Vushtrrisë, në vendvotimin me nr 1326e/02D në fshatin Krojmir në komunën e Lipjanit, në vendvotimin me nr.2731B/02D në fshatin Akrashtice në komunën e Vushtrrisë, në vendvotimin me nr.0306E/01R në fshatin Terstenik në komunën e Drenasit, në vendvotimin me nr.1115b/01R në fshatin Bare në komunën e Mitrovicës, në vendvotimin me nr.1326e/01R, në fshatin Krojmir, në komunën e Lipjanit.

Paneli, në bazë të nenit 13.2 të Rregullave dhe Procedurave të PZAP-it, ka bashkuar apelet e lartcekura dhe i trajton si një apel i evidentuar me Anr.713/2021, për shkak të natyrës së njëjtë të rasteve dhe pretendimeve për apele që përmbajnë në vete çështje të ngjashme dhe se ato apele të trajtohen me një vendim, i vendosi me një vendim për shkak të efikasitetit dhe ekonomizimit të procedurës.

PZAP-i, pas shqyrtimit të apelit, vlerësimit të pretendimeve ankimore, vlerësimit të provave të bashkangjitura dhe sipas hetimit të kryer nga vet PZAP, në ankesë në kuptim të nenit 105 paragrafi 1, dhe nenit 117 paragrafët 2 dhe 3 të LZP-së, gjeti se:

#### **Apeli është pjesërisht i bazuar**

Nga shkresat e lëndës, rezulton se kandidati për deputet të Kuvendit të Republikës së Kosovës, Rashit Qalaj, nga radhët e subjektit politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK), me seli në Prishtinë, brenda afatit ligjor, ka parashtruar apelet ku ka kërkuar nga PZAP-i, që të bëhet rinumërimi i fletëvotimeve nr.1122b/02D në fshatin Kushtove në komunën e Mitrovicës, në vendvotimin me nr.2702B/04R, në komunën e Vushtrrisë, në vendvotimin me nr 1326e/02D në fshatin Krojmir në komunën e Lipjanit, në vendvotimin me nr.2731B/02D në fshatin Akrashtice në komunën e Vushtrrisë, në vendvotimin me nr.0306E/01R në fshatin Terstenik në komunën e Drenasit, në vendvotimin me nr.1115b/01R në fshatin Bare në komunën e Mitrovicës, në vendvotimin me nr.1326e/01R, në fshatin Krojmir, në komunën e Lipjanit.

Paneli vlerëson se përderisa është bere bashkimi i apeleve, të parashtruara nga kandidati Rashit Qalaj dhe se mbështetur të provat e dorëzuara nga kandidati, apeli ka gjetur si pjesërisht të bazuara vetëm sa i përket vendvotimeve si në piken 1 të dispozitivit të këtij vendimi, nga se rezulton se në formularët e numrimit të bashkangjitur si prove, vëren ndërhyrje tek kandidati me nr. rendor 13 nga subjekti politik Partia Demokratike e Kosoves, andaj ky panel, vlerëson se ky rinumërim e bënë procesin e numërimit të fletëvotimeve dhe shpalljen e rezultateve të saktë në kuptim të nenit 101 paragrafi 1 i LZP-së, me të cilin përcaktohet se: *“Procedura e numërimit të fletëvotimeve qeverisen nga objektivat e mëposhtme: saktësia, transparencja, efikasiteti, mundësia për rinumërim dhe përsëritja e zgjedhjeve dhe mbrojtja e fshehtësisë së votës”*. Nga kjo rezulton se mos procedimi i fletëvotimeve sipas dispozitës së lartë cituar, përveç cenimit të saktësisë, transparencës dhe kredibilitetit, po ashtu cenon integritetin e procesit zgjedhor dhe se pa evitimin e kësaj parregullsie, përmes rinumërimit, ky integritet dhe kredibilitet do të vihet në pikëpyetje. Për

çka mbi bazën e të lartë cekurave Paneli, ka vendosur si në pikën -I- dhe -II- të dispozitivit të këtij vendimi.

Ndërsa sa i përket pikës 3 të dispozitivit të vendimit, sipas se cilës është refuzuar pjesërisht apeli për rinumërim të vendotimeve të përshkruara si në dispozitiv, për panelin rrjedhe se provat që ka bashkangjitur kandidati Rashit Qalaj, nuk provojnë pretendimin e theksuar në ankese nga se në asnjërin nga formularët e numërimit të rezultateve nuk vërehet asnjë ndërhyrje në rubrikën e përshkrimit të votave për këtë kandidat.

Andaj PZAP nga këto arsye, dhe në mbështetje të nenit 117.4 urdhëron që të bëhet rinumërimi i fletëvotimeve për vendvotimet e lartcekura. Si në pikën II të dispozitivit.

Prandaj më qëllim të evitimit të këtyre lëshimeve të lartë cekura dhe bazuar në nenet 115.1, dhe nenin 119.5 të LZP-së, ku parashihet se, *PZAP-i mundet që sipas vendimit të tij të shqyrtoj çështje të cilat përndryshe janë nën juridiksionin e tij kur kjo është rreptësisht e domosdoshme për të parandaluar padrejtësi serioze* po ashtu lidhur me nenin 118 paragrafi 1 dhe 120 par. Pika d) të LZP-së, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

**Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa**

Anr. 738/2021 më datën 05.03.2021.



**Këshillë Juridike:** Kundër këtij vendimi është e lejuar ankesa sipas nenit 118 par. 4 të LZP-së, në Gjykatën Supreme të Kosovës, brenda njëzetekatër (24) orëve nga momenti i marrjes-pranimi të këtij vendimi.